



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.189/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Gyltene Sylejmani dhe Adnan Konushevcu anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Arjeta Sylja, duke vendosur përkitazi me ankesën e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese BIRN dhe Internews Kosova (IKS), paraqitur kundër subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR), me seli në Prishtinë për shkak të Thyerjes së Kodit të Mirësjelljes, për Subjektet Politike, Mbështetësit e Tyre dhe Kandidatet, për Zgjedhjet Lokale që do të mbahen me datë 22.10. 2017, në seancën e panelit të mbajtur me 16.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

PRANOHETsi e bazuar ankesa e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese BIRN dhe Internews Kosova (IKS), ndërsa subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR), me seli në Prishtinë i shqiptohet dënimi me gjobë në vlerë prej 5,100.00 (pesëmijë e njëqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese BIRN dhe Internews Kosova (IKS), ka parashtruar ankesë në PZAP më datë 11.10.2017, me të cilën pretendon se kandidati për kryetar të Komunës së Prishtinës, Selim Pacolli nga radhët e subjektit politik AKR-së, ka shkelur Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme, nenin 33 pika b) dhe Rregullën Zgjedhore Nr.13/2013, neni 3.4 duke vendosur pllakata me përmbajtje politike në hapësira dhe në rrugët publike, ku në faqen e tij të Facebook-ut, ka publikuar një video ku shihen pllakatet me përmbajtje politike të vendosura jashtë hapësirave publike dhe mbi rrugët publike, afër objektit të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, si dhe afër objektit të Kuvendit të Republikës së Kosovës etj.

Në mbështetje të pretendimeve ankimore ka bashkangjitur fotografi dhe një CD, nga vendi ku ka ndodhur shkelja e Kodit të Mirësjelljes.

Subjekti politik AKR, në përgjigjen në ankesë të datës 12.10.2017, ka theksuar se në pamjet nga video promovuese vërehet qartë se asnjëra prej pllakateve nuk kanë përmbajtje të subjektit AKR, asnjëra nga pllakatat nuk e ka numrin me të cilin garon AKR-ja, apo emrin i kandidatit për kryetar të Komunës së Prishtinës, Selim Pacolli. Më tej ka theksuar se asnjëra nga pllakatat e pretenduara që kanë bëjnë me shkeljet nuk gjenden më.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Paneli nga fotografia dhe CD-ja e ofruara si provë nga parashtuesi i ankesës, të cilat gjendet në shkresat e lëndës, në mënyrë të padyshimt, ka konstatuar se kandidati për kryetar të Komunës së Prishtinës Selim Pacolli, nga radhët e subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR), ka shkelur Kodin e Mirësjelljes, nga fakti se, pllakatat e kandidatit në fjalë janë vendosur në hapësira publike, veprime këto të sanksionuara me dispozitën e nenit 33 pika b) e LZP-së, e cila përcakton: *“Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugët publike”*.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat për rastin konkret duke pasur parasysh faktin se subjekti politik AKR, nuk merr pjesë për herë të parë në zgjedhje dhe se të njëjtat janë të njoftuar me rregullat zgjedhore. Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e mori edhe faktin që këtij subjekti, ia dha mundësinë për tu përgjigjur ashtu që në përgjigje kanë mohuar shkeljen e supozuar. Pretendimet në përgjigje nga ana e panelit janë vlerësuar si pa ndikim në marrjen e vendimit më të favorshëm për subjektin në fjalë.

Paneli, për të vendosur dhe pranuar një ankesë si të bazuar vendimin e tij e mbështet në dëshmi të qarta dhe bindëse siç përcaktohet me nenin 117 par. 3 të LZP-së, ndërsa në këtë rast nga provat e administruara, ka rezultuar se Kandidati për Kryetar të Komunës së Prishtinës nga radhët e subjektit politik AKR, Selim Pacolli, në llogarinë e tij në Facebook ka pranuar vetë se ka vendosur pllakata nëpër rrugët e Prishtinës duke thënë se: *“po isha unë i cili kam vendosur shenjat nëpër Prishtinë sepse është koha që politikanët të ndalen së foluri dhe një menaxher të fillojë punën”*, ky veprim i kandidatit në fjalë është në kundërshtim me dispozitën e nenit 33 pika b) të LZP-së.

Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e mori edhe faktin që këtij subjekti, ia dha mundësinë për tu përgjigjur dhe nga përgjigja e ofruar e subjektit politik AKR nuk ka ofruar asnjë provë për të

vërtetuar pretendimet e tij se “asnjëra nga pllakatet e pretenduara në ankesë nuk gjenden më”, ky veprim ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi. Paneli po ashtu vlerësoi se dënimi me gjobë i shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi ndaj subjektit në fjalë do të ndikon që mos të përsëriten veprimet e kësaj natyre në të ardhmen.

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Zl.A.nr. 189/2017 më datën 16.10.2017



Kryesuesi i Panelit
Hasan Shala

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.